



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

---

Numri i lëndës: 2018:039154

Datë: 02.04.2019

Numri i dokumentit: 00265745

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL** Sipas gjyqtarit Nexhat Aliu, me Sek. Juridike Azize Rama, në qështjen penale të akuzuarit I. I. nga fsh., Komuna e Vitisë, i akuzuar për shkak të veprave penale kanosje nga neni 185 parag. 4, dhe vepres penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 parag.1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokuroris Shtetore nga Gjilani PP.nr. 2338/2016, të datës 30.12.2016, dhe pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqsor, dhe publik me datën 28.02.2019, shpall këte:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari I. I** nga babai Sh. dhe nëna K., i vajzeris H. , i lindur ... ne , ku dhe jeton, me nr. Personale i leternjoftimi ... ka te kryer shkollen e mesme, punon si mirmbajtes ne shkollen “...” ne fsh..., me gjendje të varfur ekonomike, i martuar, babai 4 femive, deri më tani kinse i pa denuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANE FAJTORË  
SEPSE**

**I.**

Me daten 24.10.2016, rreth ores 20;30 minuta, ne fsh... , Komuna Vitise, në rrugë për shkak se i njejt i kishte ftuat vajzen e tij dhe prej saj kishte kërkuar që të takohet me të te xhamia e fshatit, me fjal dhe veprime e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin R. M nga fsh..., komuna e Vitisë, në atë mënyrë që të njejt i del ne rrugë, tenton tia hap deren e pasagjerit dhe kerkon prej tij qe të ndalet mirpo kur e sheh ky se ai kishte nje thike në doren e pasagjerit dhe kerkon prej tij qe te ndalet mirpo kur e sheh ky se ai kishte nje thike ne dore nuk ndalet por e vazhdon rrugen dhe gjate kesaj kohene shenje revolteai e ngule thiken ne fjalë ne pjesen e mbrapme te xhamit te vetures te cilen ky ishte duke e drejtuar, me q rast te ky i demtuar ka shkaktuar ankth dhe frike, sepse sjellja e tij e fundit ishte mjaft e vrazhde dhe e frikshme.

-me qka ka kryer veprën penale, kanosje nga neni 185 parag 1 të KPRK-së.

## II.

Diten, kohen vendin dhe motivin e permendur në dispozitivin I. të kesaj aktakuze te demtuarit R. M ja ka demtuar edhe veturen e markes Volkswagen Pollo me targa te regjistrimit ... ne ate menyre qe ia ngule thiken , e lartepemendur ne pjesen e mbrapme te xhamit te vetures te cilen i demtuari ishte duke e drejtuar me qrast të njejtit ija ka demtuar pjesen e gomës se xhamit ne fjalen ne vlere te pa percaktuar.

-me qka ka kryer veprën penale, asgjesimi apo demtimi i pasurise nga neni 333 parag 1, të KPRK-së.

Në bazë të nenit 80 të KPRK-së.

## CAKTON

-Për veprën penale nga pika **I.** e dispozitivit i shqipton denim burgu në kohzgjatje prej 1 (një vit) , i cili dënim nuk do të egzekutohet, **ME KUSHT** që në afat prej **24 muajsh** mos të kryej vepër tjetër penale dhe.

-Për veprën penale nga pika **II.** e dispozitivit i shqipton denim me gjobe ne shume prej 300.00 (treqind euro) euro.

-andaj gjykata në bazë të nenit 41, 46 50, 51, e 73, dhe nenit 75 parag. 1 e neni 80, të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së.

## E GJYKON

- me denim **Unik** burgu në kohzgjatje prej **1 (një vite)** , i cili dënim nuk do të egzekutohet, **ME KUSHT** që në afat prej **24 mujash** mos të kryej vepër tjetër penale. dhe

Me denim gjobë në shumë prej **300.00 Eu, (treqind euro).**

**Denimin** e shqiptuar me gjobë do ta paguajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast të mosë pagesës i njejtë do të shendrohet në denim burgu efektiv prej **15 ditësh**, duke llogaritu nga **20.00 euro (njizeteuro)**, për një ditë burgu.

**Obligohet i** akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajn shumën prej nga 20,00 € (njizet euro), kurse në emër të paushallit gjyqsor shumën prej nga 10,00 € (dhjet euro).

I dëmtuari R.M. nga fsh... Komuna e Vitisë, për realizimin e kerkesës pasorore juridike udhohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Shtetore nga Gjilani, me datën 30.12.2016, ka ngritur aktakuzen PP. nr. 2338/2016 kundër të akuzuarit I.I. nga fsh. ..., Komuna e Vitisë, I akuzuar I. I nga fsh. ...., K. Viti, i akuzuar për shkak të veprave penale kanosje nga neni 185 parag. 4, dhe vepra penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 parag.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtorë, dhe ta denoj me denim meritor sipas ligjit.

**I akuzuari I.I** e ka pranuar fajsinë për veprat penale të cilat i vihet në barrë si në aktin akuzues. Edhe pse ka qenë i njoftuar me pasojat dhe favore të pranimit të fajsisë.

PSh-re nga Gjilani, Bahtie Ademi në fjalën përfundimtare të palve ka deklaruar gjatë shqyrtimit së sotem gjyqësor është vërtetuar vendi dhe menyra e kryerjes së veprave penale ashtu siq është cekur në aktakuzë kjo është vërtetuar edhe me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit i cili pranimin e fajsisë e ka bërë vullnetarisht andaj mbetem në teresi pranë akuzës dhe propozimet që e njëjta i përmban dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe të shqipton denim sipas ligjit, gjykatës i propozoi që të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndues si rrethanat lehtësuese të merr pranimin e fajsisë sjelljen e mirë në Gjykatë, premtimin dhe pendimin e tij.

I dëmtuari R. M. në fjalën përfundimtare të palve ka deklaruar se në të vendosë gjykata, ndërsa kompenzimin e dëmit e kërkoj .

I akuzuari I.I në fjalën përfundimtare të palve ka kërkuar nga gjykata që t' i shqipton një denim ma të butë, është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjeter penale të këtij lloji apo të llojit tjetër, ka njoftuar gjykatën se është i gjendjes së varfur ekonomike , mirmbajtjes në shkollën e fshatit .... Komuna e Vitisë.

Gjykata analizoi mbrojtjen e të akuzuarëve, provat e administruara dhe erdhi në përfundim se i akuzuarit I.I nga fsh. ...., K.Vitise, ka kryer veprat penale kanosje nga neni 185 parag.4 dhe veprën penale asgjësim apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 parag.1 të KPRK-së, që u vërtetua nga pranimi i fajsisë nga ana e vetë të akuzuarëve për këto vepra penale.

Gjatë matjes dhe shqyrtimit të dënimit, ka aplikuar nenin 75 parag. 1, të KPRK-së, ku ka ndryshuar denimin dhe ka shqiptuar llojin ma të butë të dënimit denim me gjobë duke pasur parasysh pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit në seancën fillestare pa asnjë hezitim, është penduar thellë për kryerjen e këtyre veprave penale, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, të këtij lloji apo të ndonji lloji tjetër, me gjendje të dobët ekonomike, baba i këtyre fëmijëve mbajtës i gjashtë antarëve të familjës me një rrogë minimale të mirmbajtjes të shkollës në fshatin ... Komuna e Vitisë  
Ndërsa rrethanat rëndues përgjegjësive penale, rrezikshmëria shoqërore, frigen e shkaktuar dhe pasojat e shkaktuara të dëmtuarit.

Për këtë arsye i shqiptoi denim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se edhe ky denim do të ndikoi pozitivisht tek të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450, ndërsa vendimi mbi kërkesën pasurore juridike konform nenit 458, të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
P.nr.23/2017  
2018:039154, 28.02.2019**

Sekretare Juridike,  
**Azize Rama**

Gjyqtari,  
**Nexhat Aliu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë në afatë prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:039154  
Datë: 02.04.2019  
Numri i dokumentit: 00265745